

FM 051



PËRSHKRIMI

Ngjitës fleksibël me bazë çimento, për ngjitjen e pllakave qeramike, gres, porcelan, etj.

KLASIFIKIMI I PRODUKTIT

FM 051 është klasifikuar si C2TE S1 sipas EN 12004, baza C çimento, 2 ngjitës me forcë ngjitëse të lartë, T rezistenca ndaj rrëshkitshmërisë, E kohë e zgjatur e punimit dhe S1 ngjitës fleksibël.

KARAKTERISTIKAT

- Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.
- Për ambiente me lagështi.
- Punueshmëri e mirë.
- Për fiksimin e pllakave qeramike, gres dhe porcelan në sipërfaqe të vështira, mbi pllaka ekzistuese të vjetra dhe mbi dysHEME me ngrohje.
- Për fiksimin e pllakave qeramike, gres dhe porcelan në sipërfaqe gipsi të trajtuar me FM PRIMER.

FUSHA E PËRDORIMIT

FM 051 përdoret për shtrimin e pllakave prej qeramike, gres, porcelani dhe pllakave të dimensioneve të ndryshme në sipërfaqe të ndryshme të tilla si: beton, veshje izoluese, çimento, suva, pllaka të vjetra, etj. Ky produkt është i përshtatshëm për brenda dhe jashtë. FM 051 gjithashtu mund të aplikohet në sipërfaqe të deformueshme si: pllaka gipsi, druri apo dysHEME me ngrohje qendrore kur bëhet përforsimi i tij me aditivin LATEX, i cili përmirëson parametrat teknike ngjitëse.

TECHNICAL DATA

Forma:	Pluhur
Ngjyra:	Gri, I bardhë
Sasia e ujit për hidratim:	7.5 l/25 kg thes
Temperatura e aplikimit:	nga +5°C deri në +35°C
Spesori i aplikimit:	deri në 20 mm
Koha e punimit:	të paktën 4 orë
Koha e punueshmërisë:	45 min
Rrëshkitshmëria:	0,1 mm
Mbushja e fugave në mure:	pas 8 orësh
Mbushja e fugave në dysHEME:	pas 24 orësh
Forca ngjitëse pas 28 ditësh në:	
• Kushte normale:	$\geq 1,53 \text{ N/mm}^2$
• Veprimin e nxehtësisë në +70°C:	$\geq 1,42 \text{ N/mm}^2$
• Zhytjen në ujë:	$\geq 1,55 \text{ N/mm}^2$
• Ciklet ngrirje shkrijë:	$\geq 1,34 \text{ N/mm}^2$
Rezistenca temperatore:	nga -30°C në +90°C
Deformueshmëria sipas EN 12002:	3,9 mm

PROCEDURA E APLIKIMIT

Suportet tradicionale me bazë çimento duhet të kenë një kohë maturimi të mjaftueshme prej (28 ditë në temperaturë 23°C dhe U.R 40%). Suportet duhet të jenë të sheshta dhe të qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit. Suporti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i pastër, pa lëndë të huaja të tilla si: bojra, vajra, verniqe, materiale anti-ngjitëse. Pastrimi bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Para se të aplikoni produktin, maturoni sipërfaqen për të paktën një javë në mënyrë që ajo të arrijë trashësi 1 cm.

APLIKIMI

Për një aplikim sa më të mirë të produktit si dhe për të përfutur një shpërndarje më të mirë dhe uniforme në të gjithë sipërfaqen, rekomandohet që fillimisht shtrimi i produktit mbi suport të bëhet me pjesën e drejtë të mallës, e më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Produkti duhet të aplikohet me një mallë të përshtatshme në varësi të tipit dhe përmasave të pllakës. Rekomandohet që mbas vendosjes së pllakës, të ushtrohet presion mbi të në mënyrë që pjesa e pasme e pllakës të ngopet plotësisht. Kushte të veçanta si: temperaturat e larta, erërat e forta, dielli apo nënshtresat me një absorbim të lartë të ujit, ndikojnë negativisht në performancën e produktit madje mund të ulin në mënyrë të ndjeshme kohën e hapjes dhe të korrektimit. Për të shmangur këto probleme, rekomandohet që suporti të spërkatet me ujë përpara aplikimit të ngjitësit ose të trajtohet me astarin FM PRIMER. Gjithsesi në çdo rast është e rëndësishme që përpara shtrimit të pllakës të kontrollohet nëse ngjitësi ka formuar cipë. Në një rast të tillë duhet të bëhet një rishpërndarje e ngjitësit për të riaktivizuar forcën ngjitëse. Duhet shmangur derdhja e ujit mbi ngjitësin që ka krijuar cipë (është ngurtësuar) sepse në një rast të tillë formohet një shtresë kundërngjitëse. Në rastet e aplikimit në ambjente të jashtme, këshillohet që ngjitësi të përhapet edhe në pjesën e pasme të pllakës edhe në suport në mënyrë që të mos krijohen zgavra në të cilat mund të penetrojë uji apo të formohet lagështi, të cilat mund të shkaktojnë më pas shqitjen ose thyerjen e pllakave.

PAKETIMI

Thasë letre 25 Kg.

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

12 muaj, në qoftë se ruhet në kushte normale dhe në paketimin origjinal, i mbrojtur nga ekspozimi direkt ndaj diellit dhe acarit

KONSUMI

4- 5 kg/m²

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e amballazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

